



KOMUNA E KLINËS,
KUVENDI I KOMUNËS
01. Nr. *06-1053/15*
KLINË, 26.2.2016

EKSTRAKT I POCESVERBALIT

I SEANCËS SË DYTË TË KK, MBAJTUR, MË 26.2.2016, NË ORËN 10:00, NË SALLËN E KK

Në seancë Prezantuan: Kryesuesi i Kuvendit, Dr. Haxhi Ibishi, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e Kuvendit, drejtorë të drejtorive, Komandanti i Policisë së Kosovës në Klinë, Rexhë Berisha, KFOR-i, OSBE, Zyra ligjore, Zyra e auditimit, OJQ, mediet etj.

Seancën e hapi kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të KK.

Kam një sugjerim nga një këshilltar, nga këshilltari Petrit Palushi për një deklaratë që do ta prezantojë këtu në këtë seancë.

Petrit Palushi, tha se deklaroj që nga sot t'i bashkojem grupit të asamblistëve të AAK-së dhe kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që nga sot të fillojë me procedurat e kalimit nga Grupi 3 Plus në grupin e AAK-së.

Haxhi Ibishi, tha se i respektojmë në plotni bindjet e juaja politike dhe mendimin tënd, në seancën e radhës do ta kesh edhe pozicionin ku është e organizuar AAK.

Avni Gashi, tha se unë pata për të bërë një deklaratë të shkurtër lidhur me arrestimin e asamblistit të "Vetëvendosjes" Skënder Merturi, që ndodhi pak para fillimit të seancës solemne të kremtimit të 8-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës për një veprim politik të vitit 2009.

"Domethënë, ne po ballafaqohemi me shumë probleme dhashtë Zoti që çdo gjë të shikohet kështu prej drejtësisë së Kosovës dhe asnjë veprim të mos mbetet pa u gjykuar, qoftë ajo edhe një veprim politik, për të gjithë të jetë qenë njësoj, por për ne si GP opozitar, por edhe për shumicën e qytetarëve ka qenë e papranueshme mënyra e arrestimit të asamblistit të

"Vetëvendosjes" para Kuvendit të Komunal, pak minuta para se të fillojë seanca solemne. Dhe, për këtë arsye ne kemi bojkotuar seancën e solemne për festimin e tetëvjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Ne të gjithë kemi sakrifikuar për të pasur organet tona shtetërore, që të kujdesen për të gjithë qytetarët njësoj, por kurrë s'e kam pritur që drejtësia e Kosovës të jetë kaq e politizuar. Për ta parë se sa është e politizuar mjafton për ta parë dje edhe vetë gjyqtarin i cili në deklaratë gjatë gjyqimit tha se edhe vetë jam i çuditur për këto veprime që i kanë bërë një ditë

para festimit, domethënë më 16 shkurt, madje këto arrestime janë dalë si me gërshërë pas asaj date. Shpresojmë që kjo le të jetë e fundit dhe drejtësia le të veprojë për të gjithë e jo të ketë drejtësi selektive në Kosovë”, konstatoi anëtarë Gashi.

Tunë Dedaj, tha se në emër të GP të AAK-së e falënderoj shumë z. Petrit Palushi për ardhjen në grupin tonë, dhe kërkoj që ta sistemoni aty ku duhet menjëherë në këtë seancë.

Haxhi Ibishi, tha se mendoj me mirëkuptimin tuaj, në seancën e radhës do ta bëjmë atë organizim, nuk do të keni për ta pasur asnjë problem. “Thjesht, aderimet, kalimet, janë çështje individuale dhe thjesht respektohen prej të gjithëve dhe ftoj që njerëzit të jenë të lirë në botëkuptimet e veta politike, të kenë angazhimin e vet pavarësisht prej cilit pozicion e kanë marrë votën para së të hyjnë në këtë asamble.

Vuri në miratim rendin e ditës.

Me vota unanime u miratua ky

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar për vitin 2015 (ref. Drejtorë e FEZH),
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për bartje të mjeteve të pashfrytëzuara të vitit 2015 nga të hyrat vetanake për vitin 2016 –rialokimi i tyre,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2016,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për masat disiplinore dhe kodin e mirësjelljes në të gjitha institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese në Komunën e Klinës (leximi i dyte, ref. Zyra ligjore),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të Takimit me qytetarë i dt 21.12.2015,
8. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa,
9. Shqyrtimi i peticionit të banorëve të fshatit Poterq,
10. Pyetje dhe përgjigje nga këshilltarët.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi se ka dy arsye për mungesë, për Shukrijën Shalën, e cila ka djalë të sëmure dhe arsye të saj është plotësisht i arsyeshëm, po ashtu kam arsye edhe për anëtarin Bozhidar Sharkoviq.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Me vota unanime (21) u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar për vitin 2015 (ref. Drejtorë e FEZH).

Ramiz Rrusta, drejtor i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim raportoi rreth Raportit financiar për vitin 2015. “Duke u mbështetur në Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, për Vetëqeverisje Lokale, Drejtoria e FEZH, në afat të paraparë sipas Kuvendit ju ka dërguar raportin financiar për vitin 2015 dhe besoj që me kohë e keni marrë edhe ju anëtarët e AK, por edhe ne kemi biseduar në KPF që kemi pasur para dy jave. Buxheti në sistemin e fribalancit për vitin 2015 sipas burimit, pra në tab. nr. 2, po shihet se kemi i pasur një buxhet prej 891631 euro, ku nga të hyrat vetanake kanë qenë 857767 euro, të hyrat e bartur 336511 euro, participimi i qytetarëve 55831 euro dhe ka qenë një donacion prej shoqatës Save children në vlerë prej 4150 euro, ku shuma totale është 891631 euro. Këtu kemi një krahasim në mes të buxhetit të vitit 2014 dhe atij 2015, ku në total kemi një rritje për 6.94%. Buxheti në sistemin e menaxhimit të fribalancit sipas burimit dhe buxheti i shpenzuar për këtë periudhë që po raportojmë janar – dhjetor 2015, nga GQ në totalin e buxhetit janë shpenzuar 7631770 euro, apo 85.6%. Të hyrat vetanake 857760 për 9.62%, të hyrat e bartura nga viti paraprak kanë qenë 366,511.45, apo 4.11%, participimi i qytetarëve e thashë edhe më parë, ku në përqindje është 0.62. Çka do të thotë që buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2015 është 8611908 eur, apo 4.45% për qind më shumë se sa e njëjta periudhë e vitit 2014. Shpenzimet buxhetit në periudhën janar – dhjetor 2015 sipas kategorive ekonomike: për paga e mëditje 5,570.740.44 ose 64.69%, për mallra dhe shërbime 620,164.20 ose 7.20%, shërbime komunale 170,353.02 % ose 1.98%, subvencione dhe transf. 79,501.55. ose 92%, kapitalet, 2,171,149.03 ose 25.21%. Nga kjo që del krahasimi në mes të vitit 2015 dhe vitit 2014 është diku më i madh për paga dhe mëditje për 9.56%. Në këtë periudhë është bërë edhe llogaritja e përvojës së punës për të gjitha ata që marrin paga nga BKK, edhe te kapitalet ku kemi atje një përqindje më pak 5.67%, sepse buxheti i vitit 2015 për investimet kapitale ka qenë më i vogël për afërsisht 200,000 euro në krahasim me buxhetin e investimeve kapitale që kemi pasur për vitin 2014. Në këtë vit, domethënë në vitin 2015 kemi të hyra nga kjo kategori në vlerë prej 265, 541 euro, taksat rrugore, edhe këtu kemi rritje, diku 1200 euro, urbanizëm kemi rënie, diku afër 35 mijë euro, transaksionet janë bërë në drejtorinë tonë tash kalon një taksë simbolike që bëhet në DGJK dhe shumë që është inkasuar mirë në 2014, tash kemi rënie, sepse nuk inkasohen ato por neve na del minus diku 24 mijë euro. Drejtoria e Administratës në të gjitha nivelet ka rritje, i keni përpara punët që kryhen aty, rënie kemi nga gjobat nga trafiku dhe nga gjykatat, gjobat diku minus 34,000 euro në krahasim me vitin 2014 dhe gjobat nga gjykatat minus 19.000 euro. Çka do të thotë që të hyrat gjithsej kanë qenë në shumë prej 847599 në krahasim me vitin 2014, sepse kemi pasur të hyra për 15%, ku kemi tejkaluar planin për vitin 2014, d.m.th. 115%. Raporti i shpenzimeve për këtë periudhë që po raportojmë, në tab. nr. 8, nuk kemi nevojë për t’i potencuar, sepse besoj që do të bëhet debat. Besoj që edhe shpenzimet për secilën drejtori i keni përpara të cilat janë shumë mirë të specifikuara, duke filluar për të gjitha shpenzimet që jeni të interesuar për t’i parë”, raportoi drejtori Rrusta.

Kryesuesi hapi diskutimin rreth Raportit financiar janar-dhjetor 2015.

Arben Limani, tha se GP i LDK-së pasi e ka shikuar Raportin financiar janar-dhjetor 2015 dhe i kemi evidencuar vërejtjet të cilat ne i konsiderojmë se po përsëriten vit pas viti, sigurisht se janë edhe në këtë raport financiar janar-dhjetor 2015. Po fillojmë njëherë tek tabela fq. 5, tek gjitha shpenzimet tjera, mallra dhe shërbime, subvencionet dhe transferet e posaçërisht tek shpenzimet kapitale, keni rënie në krahasim me vitin 2014, këtë e përmendi edhe drejtori, ndërsa tek pagat dhe shërbimet komunale kemi rritje. Kjo tregon për performancë jo të mirë të shfrytëzimit të buxhetit të Komunës. Përqindjet e rënies shihen edhe nga tabela. Ajo që na shqetëson më së

shumti është rënia apo zvogëlimi te shpenzimet kapitale, prej të cilave përfitojnë direkt qytetarët. Tabela në fq. 7, sa i përket të hyrave vetanake ato janë më të vogla në vitin 2015, në krahasim se në vitin 2014, për 11.82 për qind, në vend që të ishte e kundërta. Kemi rënie të të hyrave kryesore vetanake, të cilat kanë më së shumti peshë në buxhetin e të të hyrave vetanake, si rënia në tatimin në pronë, në urbanizëm, licencim, po ashtu dhe ato që i përmendi edhe drejtori, gjoba në trafik, nga gjykatat, participimet në shëndetësi dhe inspektimet. Tabela e shpenzimeve nëpër kategori ekonomike, ndoshta është pak me detale, shpenzimet që janë bërë nëpër këto kategori ekonomike, por edhe kjo nuk përfaqëson indikatorë të detajizuar të shpenzimeve buxhetore. Neve na erdhi sot me i detajizuar domethënë nëpër drejtori shpenzimi i buxhetit, por sot s'po kemi atë mundësi për ta shikuar. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të shpenzimeve buxhetore ka nevojë që më herët të na bihet një detajizim i shpenzimeve në mënyrë që t'i shikojmë më herët këto para se të vijmë në seancë. Edhe këto shpenzime, pra domethënë tregojnë për performancën jo të mirë të shpenzimeve veçmas te mallra dhe shërbimeve, përkatësisht si çdoherë ne i kemi bërë vërejtjet tona si grup këto shpenzimet të luksit të cilat vazhdimisht janë të njëjta. Edhe në këtë raport, domethënë kemi nivel të lartë të shpenzimeve, duke i marrë prej numrave rendorë, domethënë, nr. rendor 7, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, me 26342.15 euro, shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, ashtu kodi 8, me 35 37.80 euro, tek kodi 12, shpenzimet e telefonisë mobile, 24 600 56 centë. Kodi 17, të shpenzimet e shërbimeve kontraktuese, po ashtu 87 014 euro, kodi 24, shpenzimet e furnizimit për zyrë, 51896, kodi 34, shpenzimet e derivateve, 89953 euro, edhe kodi 38, riparimi i automjeteve 21562 euro, kur dihet se automjetet janë blerë tash vonë. Kjo ishte ajo që kishim lidhur me raportin, por në vazhdimësi do të ndërlihdemi edhe rreth çështjeve tjera”, nënvizoi anëtari Limani.

Tunë Dedaj, tha se edhe në si grup i AAK-së kemi vërejtjet tona për shpenzimet e tepruara. “Sipas nesh, shpenzimet për udhëtim brenda 26 mijë euro është diçka që nuk është e mirë të jetë kjo shumë kaq e madhe, edhe është mirë për ta ditur se ku janë shpenzuar këto mjete, për çka janë bërë këto shpenzime brenda vendit, kjo shumë është tepër e madhe. Gjithashtu shpenzimet e telefonisë mobile 24 mijë është një shumë tepër e madhe, sepse ne gjithmonë po e flasim por s'po kemi mundësi për ta zbritur. Bien në sy furnizimi për zyrë, 51 mijë euro, mendojmë që kjo shumë është e tepër e madhe; furnizimi për veshmbathje 9541 euro, përpos zjarrfikësve nuk dimë kush duhet të furnizohet me veshmbathje nga Komuna. Është interesant naftë për ngrohje qendrore 18 mijë euro, qymyr 10 mijë euro, dru 85 mijë euro, ku të gjitha këto bëjnë 113.000 euro, që sipas mendimit tonë shumë është jashtëzakonisht e tejkaluar. Edhe ne si grup i AAK-së nuk e votojmë këtë raport për hir të shpenzimeve të mëdha”, theksoi anëtari Dedaj.

Avni Gashi, tha se ajo që shihet këtu Komuna ka harxhuar me centë të gjitha paratë që ka pasur në dispozicion. “Ajo që kisha pasur dëshirë për ta parë në këtë raport, për ta parë një krahasim të atyre që kanë qenë të planifikuara ku janë shpenzuar dhe të atyre që janë shpenzuar çka ka mbetur pa u paguar, sa është investuar dhe jo thjesht një përshkrim 4-5 slajde se si janë shpenzuar këto mjete. Kjo tabelë për mendimin tim vetëm tregon që janë shpenzuar mjetet, absolutisht nuk na ofron informatë se nga kanë shkuar ato mjete dhe kush janë përfituesit final të tyre. E di që ky lloj raporti, është bërë një lloj standardi, por nuk është diçka që na thotë neve rreth shpenzimeve të buxhetit, vetëm na tregon se janë harxhuar me centë dhe më nuk di dhe nuk dimë as cilat janë obligime të mbetura, absolutisht nuk e dimë se cilat projekte janë ende duke u punuar apo janë obligime që ka hyrë Komuna për vitin 2016, kështu që edhe unë tash me grup pak më të vogël, që duhet t'ia ndërrojmë emrin edhe grupit, jam kundër këtij raporti”, shtoi anëtari Gashi.

Vlora Tafili, tha se desha për t'u ndërlidhur te shpenzimet telefonike, që i hasim në dy kategori: shpenzimet e telefonisë mobile me 24, 000 euro dhe shpenzimet telefonike tek mallrat e shërbimet 7.000 euro. "Ne e dimë që zyrtarisht e kemi një kontratë, një marrëveshje me IPKO, a jeni duke e raportuar edhe borxhin e "Valës 900", apo qysh gjithë këto shpenzime të mëdha?- shoti anëtarja Tafili.

Ndue Shabanaj, tha se fillimisht kam vërejtje për këtë material, te faqja 7 me vështirësi lexohet dhe është shumë vështirë për t'i nxjerrë këto shënime që janë këtu, ishte dashur të ketë kujdes në përgatitjen teknike të këtij materiali. "për bindjen time është për brengosje niveli i ulët i inkasimit të tatimit në pronë që tregon se ka rënie mbi 4 mijë. Unë mendoj që kjo çështje duhet të na brengos të gjithëve dhe pushtetin lokal përgjithësisht, po ashtu edhe AK, se realisht ndërsa presim rritje të tatimit në pronë ne kemi rënie. Arsyeja ndoshta ekziston, mirëpo unë nuk e di. Nëse ka arsye për këtë, arsyeja është e veçantë, mirëpo është mirë për t'u in formuar AK. Çështje tjetër është mendoj, disa dënime që janë, këtu janë disa dënime mandatare të inspeksionit, 2280 euro dhe kjo ndoshta mund të shpjegohet dhe është mirë të shpjegohet. Ose komisioni inspektues minus 3360 euro, për bindjen time ishte dashur të jemi më të qartë ku është arsyeja e saj. Participimi te shëndetësia, minus 1 mijë e diçka, nëse është e drejtë dhe duhet të aplikohet ai participim domethënë duhet të jetë i barabartë për të gjithë dhe atëherë do të ishte i mundshëm edhe realizimi. Sa i përket shpenzimeve janar – dhjetor 2015 kohë pas kohe gjatë shqyrtimit të raporteve periodike të vitit 2015 ne i kemi dhënë mendimet dhe sugjerimet tona, nuk është e terptë për t'i potencuar edhe tash, ndoshta shpeshherë ekziston arsyeja, por kur nuk elaborohet, nuk shpjegohet, krijohet huti në këtë drejtim. Te shpenzimet e telefonisë mobile 24 000, ne jemi të njoftuar që secili e ka të limituar shumën e lejuar të shpenzimeve nga telefonia. Nëse ajo shumë tejkalon atë kriterin që është i lejuar natyrisht që është dashur që të merren masa ndaj njerëzve që kanë krijuar shpenzime të panevojshme dhe të paarsyeshme e jo të mbulohen ato shpenzime. Unë jam për atë që strikt të precizohet, aq është e drejtë e drejtorit apo dikujt tjetër për të shpenzuar dhe të mos mbulohen shpenzimet e tepuara. Karburantet për vetura, një kategori tjetër e veçantë, 89 953.64, që është shumë e madhe dhe se ka mundësi të reduktimit të këtyre shpenzimeve. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, edhe për këtë kategori unë besoj se ka mundësi të një kontrolli më të mirë edhe të një reduktimi të shpenzimeve. Janë këto disa vërejtje që kam dashur t'i them dhe i thashë këtu", nënvizoi prof. Shabanaj.

Rasim Millaku, tha se edhe unë do të ndalem në shifrat që janë prezantuar këtu, dhe nga këto shifra pikërisht nxirret e dhe puna, përkatësisht performanca e krejt ekzekutivit, ne veçanti edhe drejtorive. Duke qenë se janë transparente nuk ka asgjë te keqe edhe ne të kërkojmë pak a shumë aty ku ka ngecje, duke filluar prej të parës, tatimi në pronë, ka ngecje në disa mijëra euro, mirëpo në përqindje nëse shihet është një 5 për qind, d.m.th. nuk është shumë shqetësuese se sa në kategoritë tjera që shihen këtu dhe nga kjo ngecje nëpër drejtori përkatëse, duke filluar prej urbanizmit që është rreth 40%, transaksioneve u tha që nuk ekzistojnë më 97 %, por për shkak të sqarimit nuk merremi me te, dhe në kategoritë tjera, dënime mandatore dhe komisionet inspektuese mbi 60%. A është bërë ndonjë analizë, pse? A ka ndonjë planifikim jo të mirë nga këto të hyra, mirëpo kemi edhe progres. Ka drejtori që ka progres 20%, 60%. Meqenëse ka regres dhe progres është mirë që drejtoritë përkatëse të bëjnë ndonjë analizë përkatëse, pse i kanë ndodhur kjo rënie e të të hyrave. Domethënë ka një disiplinim në disa kategori që ne u kemi bërë vërejtje, është për t'u lëvdur, meqenëse akoma mbetet për t'u përmirësuar. Një kategori që po shoh këtu, mirëpo nuk po e kuptoj, telefona me pak se 1 mijë euro, janë dy drejtori, me siguri është ndonjë obligim që e di drejtori i Ekonomisë dhe shpenzimet tjera pothuaj se janë që

domethënë të disiplinuar lehtë, që me siguri është si produkt i kritikave tona që i kemi bërë në të kaluarën”, shtoi anëtari Millaku.

Ramiz Rrusta, tha se do të bëj përpjekje që t’u përgjigjem në vërejtjet që i bëtë këtui. “Më e mira prej të mirës është që buxheti është shpenzuar diku 97 për qind. Ka komuna që as 80 për qind nuk kanë mundësi të shpenzojnë buxhetin ne kemi shkuar në këtë përqindje që potencova dhe kjo është pozitive .Ishte pyetje, pse te investimet kapitale ka rënie, investimet kapitale në vitin 2015 kemi pasur buxhet më pak për 200 mijë euro se sa në vitin 2014. Domethënë që buxheti për investime kapitale ka qenë më i vogël për 200 mijë euro. Te shpenzimet tjera, qoftë dreka zyrtare, që kemi rënie, në secilin vit kemi rënie në këtë kategori; te shpenzimi i telefonit, ne kemi marrë një vendim me BD dhe Kryetarin dhe jemi në procedurë, është veç muaji i dytë që të gjithë drejtorëve të cilët i kanë tejkaluar shpenzimet, të gjithë jemi duke i kthyer shpenzimet e tepërta , përkatësisht jemi duke i bërë ndalesat e shpenzimeve të tepëruara për ata drejtorë që kanë tejkaluar limitin e përcaktuar të shpenzimit të telefonisë. Udhëtimet brenda vendit, asnjë udhëtim nuk është që ka bërë dikush prej zyrtarëve apo Kryetari i Komunës. Këtë kategori të shpenzimeve e bëjnë, sipas një marrëveshje që ka DKA, që disa nxënës të Komunës sonë transportohen në Pejë dhe Prizren dhe ata nxënës janë me nevoja të veçanta, sepse ne nuk kemi vend për sistemim dhe ata shkollohen në Pejë dhe Prizren. Riparimi i automjeteve, secila drejtori i ka veturat nën menaxhim, shpenzimet i keni atje, ndërkaq unë i paraqita shpenzimet në detale , por i keni edhe për drejtori edhe në mënyrë orientuese për secilin drejtor çka ka shpenzuar. Te ngrohjet qendrore, janë diku 18 mije euro derivate, dihet se kemi 5 shkolla me ngrohje me naftë që ngrohen edhe e rritë këtë kategori të shpenzimeve. Por te shpenzimet në përgjithësi duhet për ta ditur në këtë vit kemi pavarësimin edhe të 2 shkollave tjera, sh.f. në Çabiq dhe në Volljak, që krijojnë edhe shpenzime të tjera. Te inkasimi i nivelit të ulët të tatimit në pronë, është një përqindje e vogël, diku minus 1 për qind, vitin e kaluar besoj që ka ndikuar falja e borxheve nga niveli qendror i MF që mori vendim që të falen ato borxhe deri në periudhën deri më 31 dhjetor 2008 dhe njerëzit kanë hezitur dhe kemi pasur një farë kamufillimi, sepse vinte sa ka borxhin, por prapë se prapë jemi të kënaqur me këtë kategori, se diku 4 500 euro janë minus në krahasim me vitin e kaluar. Vitin e kaluar kemi pasur thyer rekord. Na ka ardhur regjistri për personat fizik dhe juridik të cilëve u falën borxhet e kamatave dhe ne do të bëjmë një publikim të të gjithë emrave, janë persona fizikë të gjithë komunës sonë, sa i falet kamata në këtë periudhë dhe po që se paguan deri në gusht 2016 i falet kamata për periudhat e kaluara që nuk i ka paguar, sepse nganjëherë më e lartë është kamata se sa vetë borxhi te personat fizikë. Te gjrobat në trafik, nuk varet nga ne, ne i kemi paraqitur vetëm si të hyra sa janë realizuar, po ashtu edhe në gjykatë nuk jemi ata që diktojmë. Po them që shpenzimet janë duke rënë, përkatësisht duke u reduktuar, në bazë të mundësive çfarë punohet dhe është duke u punuar në mënyrë të arsyeshme dhe shpenzimet janë konform punës që bëhet”, ka sqaruar drejtori Rrusta.

Baki Gashi, drejtor i Urbanizmit, tha se Rasim Millaku e ceku se inkasomi i ulët në urbanizëm, mirëpo dua të sqaroj se arsyeja qëndron, sepse urbanizmit realisht të hyrat i realizon përmes kërkesave të dhënies së lejeve ndërtimore, realisht në vitin 2015 kemi pasur më pak kërkesa dhe kjo është arsyeja.

Kolë Prenaj, drejtor i Inspektoratit, tha se sa i përket inkasimit të Inspektoratit këtui është një krahasim në mes të vitit 2014 dhe 2015, kështu që më 2014 e kemi tejkaluar realizimin 80 për qind, ndërsa me 2015 jemi në nivel që është i paraparë. Kështu që e kemi një problem tjetër se është një centralizim që kompetencat e inspektoratit janë duke shkuar në nivel qendror. Kështu

që bukur vështirë është që të inkasohet sa duhet sikurs më parë. Këtu është bërë një konflikt i madh administrativ. E kemi inspektorin sanitar mungesë për shkak të nivelit qendror, i punës ka kaluar në nivel qendror dhe ky është problemi pse inkasomi është më i ulët”, sqaroi drejtori Prenaj.

Tunë Dedaj, tha se dëgjova mirë drejtorin dhe e tha se mburrem që kem i realizuar 97 për qind i kemi shpenzuar mjetet, por ato duhet për tu shpenzuar me investime e jo më shpenzime të tepërta.

Ndue Shabanaj, theksoi se është mirë që i kemi shpenzimet edhe për drejtoritë përkatëse se shihet pasqyra e qartë për secilën drejtori. Ne nuk ndalemi te drejtoritë por te kategoritë e veçanta dhe është çështja aty ku drejtoria ka tejkaluar shpenzimet është çështje e ekzekutivit që merret me te, e jo e AK për drejtoritë përkatëse por çështje e ekzekutivit komunal që merret me drejtoritë përkatëse që kanë tejkaluar shpenzimet. Prandaj, ne i ngrehim si shqetësime të përgjithshme e jo, nuk i jap vetes të drejtë të merrem me drejtori. Unë kam respekt për atë që e thatë por kjo që jam duke e thënë unë është e lidhur drejtpërdrejt me ekzekutivin komunal i cili realisht e përcakton përgjegjësinë e drejtorive që ka shpenzime”, vlerësoi prof. Shabanaj.

Haxhi Ibishi, tha se të pranishëm në sallë jemi 24 këshilltarë, e vej në miratim Raportin financiar për janar-dhjetor 2015.

Me 13 vota për, 11 kundër pa abstenime u miratua Raporti financiar janar-dhjetor 2015.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për bartje të mjeteve të pashfrytëzuara të vitit 2015 nga të hyrat vetanake për vitin 2016 –rialokimi i tyre.

Kryesuesi fioli rreth rendit të ditës, fjalën e barti te drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Ramiz Rrusta, tha se në KPF kemi biseduar dhe bazuar me ligj dhe me kohë ju kemi sjellë një vendim të bartjes së mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2015 në vitin 2016. “Të hyrat vetanake, i keni shkresat aty, mirëpo unë vetëm dua t’i jap shumat e përgjithshme, ku dhe sa barten, është një vlerë prej 206 498 euro dhe kjo kategori shkon në mallra dhe shërbime, janë pra 27 121 euro, programet administratë 10 665 euro, buxhet dhe financa 5 096 euro, Zyra e Kryetarit 573 euro, ndërsa në planifikim urban 2 877 euro, pra këto shkojnë në arsim dhe shkencë, ku i kemi edhe programet edhe nënprogramet. Ndërsa në kategorinë e shpenzimeve komunale kanë qenë shuma e mbetur prej 29 euro, që shkon në DF, subvencionet dhe transveret 8 356, pra Zyra e Kryetarit, ndërsa pjesa më e madhe e shpenzimeve kapitale në shumën prej 168 711 euro kalon në një pjesë 15 940 bashkëfinancim me donatorë, kodin e ka përpara, dhe shërbimet publike, infrastrukturë rrugore, shuma prej 30 000 euro, që shkon ndihmë për nevoja emergjente 10 000 euro, ndërsa mirëmbajtja e hapësirave publike dhe ndriçimi 20 000 euro, pra vlera 30 002 euro. Planifikimi urban dhe mjedisit shumë prej 1 22 723 kalon te ndërtimi i objektit për banim për familjet e dëshmorëve, vlera prej 100 000 euro dhe asfaltimi i rrugës së qytetit 22 723 euro. Pra, në tabelarin e keni shpërndarjen e mjeteve nëpër programet buxhetore edhe nëpër kategoritë ekonomike. Sa shkojnë në paga dhe mëditje prej 2 277 euro, shërbimet për shëndetësi, mallra dhe shërbime 27 121 euro, administrata 10 000 e diçka, shpenzime komunale është një shumë e vogël 30 euro, te subvencionet dhe transeferet 8356 euro, shpenzimet kapitale

pra vlere më e madhe 168 711 euro, që në total shuma e përgjithshme e mjeteve që duhet të barten nga viti i kaluar është 200 6498 euro. Në tabelarin tjetër e keni shpërndarja të mjeteve të shpenzimeve kapitale nëpër kategori. E di që do të më bëni pyetje, pse këto mjete? Para se të më bëni këtë pyetje unë po ju përgjigjem: Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë të hyra të cilat janë realizuar në muajin nëntor dhe dhjetor, atëherë ne nuk kemi të drejtë të bëjmë pagesa, por inkasojmë të hyrat deri më 31 dhjetor të vitit që lamë pas”, sqaroi drejtori Rrusta.

Haxhi Ibishi, tha se në KPF të gjitha partitë politike që përfaqësojmë në këtë kuvend aty kemi dhënë “izën” që këto mjete të barten për shfrytëzim për vitin 2016 dhe nuk mendoj që ka ndonjë pengesë që të shkojmë drejt votimit për arsye se ka qenë një koncensus i përgjithshëm yni që të shkohet në këtë drejtim.

Fadil Gashi, tha se koncensusin ia kemi dhënë por ne kemi kërkuar që për këtë seancë le të shikohet mundësia e bartjes së këtyre mjeteve nëpër ato ku ju u keni borxh, komiteteve, u keni borxh komisioneve që i ka ndërtuar ky kuvend, bile gjatë e kemi debatuar në KPF këtë pjesë. “Është dashuri drejtoria në këtë rast për ta parë mundësinë ose të na vije me një variant dhe të thuhet “nuk kemi gjetur mundësi të këtyre mjeteve për t’i bartur te këto pagesa”. Realisht jemi duke bërë shkelje, po i shkelim vendimet tona, vendimet që i ka marrë ky kuvend. Unë nuk do dua për të akuzuar as arsyetuar as drejtorinë, as ekzekutivin, por realiteti është ky që kemi sjellë jo një herë vendimin në këtë kuvend. Ka ardhur UA i Qeverisë, i ka ardhur drejtorisë ky i fundit, edhe që bien ndesh njëra me tjetrën, tash duhet për të gjetur cila është rruga, apo kursi që duhet gjetur, por unë kisha kërkuar që duke iu mbetur borxh këtyre trupave, këtyre komiteteve, këtyre komisioneve, që i ndërtojmë vetë, sinqerisht nuk është serioze”, konstatoi anëtarë Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se kështu siç e thatë z. Gashi, ne jemi marrë vesh, por edhe unë nënkuptova në atë drejtim. “Drejtori ka thënë që më rishikimin e buxhetit që do të bëhet në qersho, ka thënë në mënyrë retroaktive do t’i destinojmë këto mjete për pagesë dhe në mënyrë retroaktive për gjithë këtë vit për t’i paguar. Edhe është një dakordim i gjithë shefave të grupeve kuvendare dhe përfaqësuesve në KPF-së”, sqaroi kryesuesi Dr. Ibishi.

Ramiz Rrusta, tha se dihet që ato komisione që i përmendëm dhe kemi biseduar edhe në KPF që janë bukur shumë. “Këto mjete nuk mund të ridestinohen në paga dhe mëditje, dihet se prej pagave dhe mëditjeve kryhen ato. Ne për paga dhe mëditje binduni që janë diku 2 mijë e diçka euro që i kemi qitur në shëndetësi dhe kemi minus në paga për këtë vit. Ne kemi mundësi në rishikim të buxhetit nëse ju që me i zvogëluar mallrat dhe shërbimet mundemi prej asaj kategorie për t’i kryer obligimet ndaj të gjitha komisioneve. Mirëpo, dua t’ju them se kemi formuar komisione, unë çdo respekt, nuk jam kundër komisioneve, edhe vetë udhëheq një komision që dy vite por asnjë cent nuk e kam marrë, mirëpo duhet kuptuar se nuk kemi mjete buxhetore, janë diku 25 vetë që rrokin një shumë të madhe të mjeteve, diku 15 000 euro në vit, kah t’i marrim ato mjete? Nëse vendosni që me rishikim të buxhetit në qershor të zvogëlohen mallrat dhe shërbimet dhe të gjendet një modus se qysh të paguhet ata unë jam për t’ia paguar. Mirëpo ju lutem mos formoni komisione, grupe, pa ardhur në buxhet dhe të shikohet a ka mjete. Ne kemi probleme me punëtorët e pastrimit, është ndërprerë kontrata me atë kompaninë, janë mjetet, dje kemi marrë vendim për t’i dërguar, nuk na ka lejuar Thesari në Prishtinë për t’ju bërë pagesën punëtorëve tonë”, tha drejtori Rrusta.

Halil Desku, tha se nuk di pse po lidhemi me atë qysh kemi folur dhe kemi vepruar në seancën e KPF-së. “Një punë dihet se drejtori ka thënë se këto mjete qysh janë paraparë nuk lëvizin,

mirëpo ky e ka thënë variantin e pas rishikimit të buxhetit. Për këto kemi marrë vendime më shumë se një herë, prandaj të mos na kërkojë të marrim edhe një herë vendim, mirëpo po kërkoj nga drejtori, një vendosmëri të tij të thotë po dhe unë kam për t'u angazhuar në rishikim këto mjete për t'i ndarë, ky e di kah i qet dhe cfarë bënë, votimin e kemi bërë”, shtoi prof. Desku.

Haxhi Ibishi, tha se nuk është vendim i kësaj çështje i asamblesë dy herë apo tri, por është gatishmëri publike që kryetari Bashota përmbi dy herë i jemi drejtuar që të gjendet forma e pagesës së këtyre komisioneve, prandaj jemi të dakorduar të gjithë dhe le të mbetet që brenda afatit që në rishikim të buxhetit në qershor që kemi, të gjendet, forma e pagesës, duke i respektuar ligjet në fuqi. Në qoftë se ligjet nuk lejojnë vijmë në situatë ku thonë edhe Thesari, edhe i Financave “nuk bën” dhe duhet kuptuar që nuk bën, qysh është ajo, “niveli qendror përjashton nivelin lokal”, ne jemi njerëz dhe respektojmë atë vendi”, pohoi Kryesuesi.

Tunë Dedaj, tha se desha ta pyes drejtorin pse ju ka mbetur borxh komisioneve të obliguara, KPF-së dhe Komitetit për Komunitete.

Haxhi Ibishi, të gjithë jemi në të njëjtat valë, le të gjendet forma e pagesave në mënyrë retroaktive të kësaj problematike që është duke na përcjellë në vijimësi.

Rasim Millaku, tha se për hir të sqarimit: “Komisione dhe komitete, nuk e di pse duhet disa herë për ta sqaruar, edhe më keq nëse duhet sqaruar një drejtor ekzekutiv ose një bartësi të një funksioni të lartë shtetëror. Komitetet janë trupa konsultative të drejtorive të formuara nga Kuvendi, duke filluar nga shëndetësia, një prej tyre që jam unë, për pronë, janë 6 ose 7 trupa konsultative që ndihmojnë me punën e tyre drejtpërdrejt drejtorive përkatëse. Nëse edhe drejtori për Ekonomi ka një komitet, ose duhet ta ketë një komitet i cili i ndihmon më këshilla, për mbarëvajtjen e punëve në drejtori. Komitetet janë me ligj të paraparë, nëse një komitet duhet të paguhet, duhet paguar të gjithë komitetet, nëse s'ka mundësi buxhetore, ka mundësi buxhetore, se vi nga një përvojë dy mandatore të drejtorisë ku di që ka mundësi buxhetore për të kryer obligimet ligjore, dhe ne nuk kemi nevojë për të gjetur mirëkuptim, por thjeshtë për ta zbatuar ligjin. Ne nuk po kërkojmë mëshirë, por thjeshtë kjo është një diçka që nuk është duke u zbatuar, komitetet janë duke lënguar. Komiteti që bëj pjesë në të disa seanca nuk është duke i mbajtur, sepse nuk vinë anëtarët me siguri për shkak edhe të kësaj, ndërsa aty ku paguhen janë duke funksionuar komitetet. Ligji është mbi ne, ne jemi asgjë më shumë as më pak vetëm për ta respektuar ligjin. Shpeshherë kur ne kritikojmë për shpenzime te tepruara, mirëpo këto kritika kanë diktuar që edhe shpenzimet të disiplinohen. Nëse ka pasur mundësi ligjore për t'u tejkaluar deri në 4-5 mijë euro shpenzimet për drekat zyrtare, cili ligj i ka lejuar ato. Ato pagesa janë të parapara me ligj ose kjo asamble duhet vetë marr vendim që këto trupi për t'i pushuar, nuk di më qartë qysh ta them”, vlerësoi anëtari Millaku.

Ramiz Rrusta, tha se unë e di që vetëm dy komitetet obligative që paguhen, është KPF dhe Komiteti për Komunitete. “Komitetet, komisionet, quani si të doni , unë nuk jam pengesë për mospagesën e komisioneve tjera, edhe thashë se nuk na kanë kaluar dje në Prishtinë për pagesën e punëtorëve ose unë jam duke respektuar një vendim të MF që farë mirë nga 2 kopje ju kam sjellë”, shtoi drejtori Rrusta.

Vlora Tafili, tha se drejtor ne në asamble kem i miratuar një vendim të veçantë, një rregullore të veçantë që të paguhen edhe komitetet tjera. “Unë jam në KSHP nuk kam pagesë, mirëpo ne jemi

duke i mbajtur mbledhjet. Desha të them, atëherë pse nuk po i shfuqizoni ato rregullore që i kemi miratuar, atëherë shfuqizoni në mënyrë që të mos bëjmë shkelje”, pohoi anëtarja Tafili.

Kryesuesi vuri në miratim vendimin për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake prej vitit 2015 për vitin 2016.

Me 20 për, pa kundër dhe pa abstenim u miratua vendimi.

Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2016.

Enver Berisha, tha se besoj që materialin rreth sigurisë në bashkësi e keni marrë me kohë, por në mungesë që t’ju sigurojmë në muajin janar këtë plan për shkak të rrethanave tona si këshill komunal që kemi pasur, jemi vonuar për një seancë, dhe është dashur të sjellim sot këtu për ta aprovuar për shkak se KKSB e ka një obligim të veçantë që është i ndërtuar me vendim të Kryetarit dhe në bazë të UA. Ky këshill e ka hartuar këtë plan të punës për periudhën 2014-2016, mirëpo ne kemi vendosur që në këtë vit për t’i paraparë edhe ndryshimet se cilat do t’i kontribuojnë punës sonë. Ne jemi të obliguar që 6 seanca brenda vitit t’i mbajmë. Ky plan është i ndërtuar mbi 9 pika, të cilat ne si këshill komunal i kemi vlerësuar që janë hallkat dhe shtyllat kryesore që i kontribuojnë situatës në bashkësi. Nuk do të hyj në detale, do të hy vetëm rreth një ndryshimi që kemi bërë në takimin e fundit që kemi pasur në KKSB më dt. 25.2.2016, në 3-4 pika që janë paraparë. Vlen për t’u potencuar këtu një marrëveshje që kemi me një organizatë joqeveritare rreth ndriçimit publik, edhe këtë vit do të vazhdojmë bashkëfinancimin që kemi pasur vitin e kaluar, ky ndriçim publik do të vazhdojë nga hyrja kryesore e Klinës tek ura, në drejtim të rrugës Pejë-Prishtinë, domethënë rruga kryesore dhe në disa lagje tjera. Po ashtu kemi menduar për ta vazhduar në 2-3 drejtime tjera të rrugëve që lidhen me pjesën e Pejës, fjala është deri te Videja dhe për Dresnik, kjo është pak edhe me kërkesën e shërbimit policor të Kosovës për shkak të incidenteve që po ndodhin kryesisht në zonën e Dresnikut, të ketë një mundësi më të mirë të menaxhimit të kësaj situate. Mandej kemi menduar se kësaj here duhet të shtyhet projekti i vendosjeve të tabelave të emërtimeve të rrugëve dhe shesheve për shkak se AK vitin e kaluar veç e ka nxjerrë vendimin dhe kështu që brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm ta bëjmë edhe vendosjen e tabelave në mënyrë që të dihet adresa e secilës rrugë veç e veç. Një rrethanë e re që është krijuar për mirë është bashkëpunimi me GIZ-in gjerman. Ne bashkë me grupin punues kemi qenë në një takim dhe kemi nënshkruar një marrëveshje të bashkëpunimit e cila do të rezultojë fillimisht me një fond bukur të mirë që do të ndihmohet Klina në trajtimin e mbeturinave, kjo në dy segmente, në pajisjen e mjeteve të punës dhe me kontejnerë për shkak se Klina është renditur ndër komunat e para në Kosovë sa i përket shtrirjes së grumbullimit të mbeturinave dhe të inkasimit. Domethënë Klina në bazë të vlerësimit që ka bërë edhe Ministria e Shërbimeve Publike dhe GIZ-i gjerman Klina është e para. Ne fillimisht e kemi i një grant prej 150 000 euro, por me kusht po që se i plotësojmë edhe dy kritere që janë, eliminimi i deponive të egra, domethënë të materialeve të gupta dhe angazhimin e një zyrtari për çështje të ambientit në kuadër të DSHP, ne këtë shumë ka mundësi për ta dyfishuar. Kjo do të ndodh brenda këtij viti. Një shqetësim i vazhdueshëm që ka qenë jo vetëm i këshillit, por edhe për ju si asamble dhe i gjithë qytetarëve të Klinës është trajtimi i qenve endacakë, për dijeni tuajën ne kemi shpallur tenderin për trajtimin e këtyre qenve endacakë, ku presim që brenda 20 ditëve do të caktohet edhe tenderuesi se kush do të merret me këtë problematikë. Domethënë është në procedurë e sipër në eliminimin e qenve endacakë. Preferencë e KKSB është vendosja e kamerave shtesë në drejtim të lumit Klina, kah është e rregulluar pjesa e shtratit të lumit Klina, për shkak se jemi

dëshmitarë të dëmtimit të ulëseve, të poçave, shportave të mbeturinave, kështu që duam të vendosim edhe atë pjesë nën menaxhim të këtyre kamerave. Po ashtu kemi vendosur që ta bëjmë vendosjen e kamerave në 4 shkolla të qytetit të Klinës, në dy shkollat e mesme dhe 2 fillore. Një kërkesë që ne do t'i drejtohem edhe ekzekutivit që ka dalë nga KKSBB rritja e numrit të stafit të zjarrfikësve për shkak se jemi nga komunat me stafin më të vogël të punëtorëve në Kosovë, duhet të shikohen edhe mundësitë buxhetore fare i ka edhe komuna. Një kërkesë që ka dalë nga Policia e Kosovës që t'i drejtohem edhe DU, si shqetësim i KKSBB është zgjerimi i disa rrugëve, në disa zona ku realisht ka edhe pengesa kalimi i automjeteve. Dhe kërkesë e KKSBB është për DU infrastruktura për njerëz me aftësi të kufizuara, përkatësisht me nevoja të veçanta, aty ku mungojnë kushtet, sepse është një prej kritereve edhe asaj kategorie duhet kushtuar kujdes dhe duhet t'u krijojmë kushte edhe mundësi që edhe ata t'i kryejnë shërbimet e veta në mënyrën sa më të lehtë, derri te e fundit respektimi i të drejtave të njeriut. Ne si KKSBB në bazë të vlerësimeve tona që kemi bërë kemi vlerësuar se në të gjitha segmentet e jetës në komunën tonë ka pasur një trajtim të barabartë për secilin qytetar, cilido nacionalitet, dhe fatbardhësisht falë bashkëpunimit me policinë e Kosovës në Klinë, kemi ngritur ta kemi situatën në vazhdimësi në kontroll dhe nuk kemi pasur incidente të natyrave të rënda, përpos atyre rasteve që janë bërë temë jo vetëm në Klinë por në Kosovë dukuria e hajnive sidomos të atyre shtëpive të zbrazëta. Kryesisht ky është plani vjetor që ne kemi menduar t'ju ofrojmë juve, po që se ka ndokush për të shtuar ne mirëpresim", raportoi nënkryetari Berisha.

Violeta Zefi, tha se unë e dëgjova me vëmendje shpalosjen e Planit të Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për këtë vit (2016), nga nënkryetari i Komunës. Konsideroj se janë disa pika të cilat do të duhej të u jepej prioritet me i madh, p.sh. rekomandoj që fushatat vetëdijesuese për parandalimin e dukurive negative (kundër drogës, duhanit etj.) të organizohen me shpesh, e jo vetëm brenda një muaji të caktuar, meqë edhe këto fushata vetëdijesuese nuk implikojnë shumë të mëdha buxhetore (pra, aktivitetet ose iniciativat e tilla mund të implementohen me shumë të vogla parash). Janë shumë të rëndësishme këto fushata e sidomos kur ato organizohen për kategorinë me të ndjeshme të shoqërisë, nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Klinës", konstatoi anëtarja Zefi.

Vlora Tafili, tha se kam një pyetje për nënkryetarin, te ndërtimi i kapaciteteve për reagim dhe fatkeqësi natyrore, vlerësimi i nevojave të stafit për Njësinë e zjarrfikësve apo rritjen e kapacitetit të numrit të zjarrfikësve, nuk e di qysh e ka paraparë në këtë për Këshillin komunal rritjen e numrit të zjarrfikësve, nuk di ku do t'i çoni ata punëtorë, sepse së pari duhet ndërtuar një herë stacionin e zjarrfikësve, nuk e di dhe se a keni paraparë buxhet, atëherë për të menduar për këto gjera, se po me duket pak e pakuptimtë", theksoi anëtarja Tafili.

Enver Berisha, iu përgjigj interesimit të anëtares Zefi dhe Tafili "Kjo nuk mjafton brenda një muaji të kryhet, ne veç kemi filuar dhe në bashkëpunim me policinë e Kosovës jemi duke hospituar nëpër shkollat fillore rreth dukurive negative, por ne do të vazhdojmë edhe në të ardhmen Realisht nuk varet kjo shumë herë vetëm në kujdesin dhe vullnetin tonë, sepse po na nevojiten edhe mekanizma tjerë Duhet falënderuar komandantin e PK në Klinë, Rexhë Berishën, i cili është jashtëzakonisht bashkëpunues në të gjitha temat që ne deri me tash i kemi pasur dhe besoj që kjo në të ardhmen veç ka për t'u shtuar. Mirëpo, ne do të kërkojmë edhe nga drejtorët e shkollave të cilët bashkë me stafin arsimor t'u kushtojnë pak më shumë rëndësi këtyre temave. Ndërsa, sa i përket pyetjes së dytë rreth objektit të zjarrfikësve, objekti është i ndërtuar të cilin sivjet presim vetëm mbulojën t'ia vëmë, përndryshe është i ndërtuar, ndërsa sa i përket

kapaciteteve në njerëz kemi kërkuar për shkak se vitin e kaluar jemi pajisur me një kamion të zjarrfikësve që është më modern me të gjitha pajisjet, që pak komuna në Kosovë e kanë dhe po shpresojmë që tash ai kapacitet ka nevojë edhe për punëtorë shtesë.

Vlora Tafili, tha se e dimë se gjendja është shumë e keqe, e kam vizituar dhe e kam parë pjesën e sipërme qysh është e dëmtuar prej kushteve atmosferike, edhe gjendja në të cilën gjenden tash punëtorët e zjarrfikësve është shumë e rëndë. “Është e vërtetë që është siguruar një kamion, por kushtet tjera të punës mungojnë, plus nuk keni buxhet, nga do t’ia mbani?!“- shtoi anëtarja Tafili.

Enver Berisha, sqaroi se KKSBB nuk është drejtori, KKSBB më shumë preferon, d.m.th. jep sugjerimet e veta drejt ekzekutivit, drejt drejtorive veç e veç. A”i objekt në këtë vit do të përfundojë së nderuari”, shtoi Nënkyetari.

Gjokë Lleshaj, tha se nënkryetari sqaroi çështjet e KKSBB, mirëpo Vlora ka do të drejtë që e thotë për objektin e zjarrfikësve. “Vlora, jo që ka të drejtë, por shumë të drejtë, kur flet për objektin e zjarrfikësve, janë disa kompetenca që vërtet na janë përzier, sepse statusi i zjarrfikësve akoma nuk është definuar, a janë me nivelin komunal apo nivelin qendror. Sa i përket objektit gjendja nuk është shumë e mirë, kati i parë është i përfunduar, por dëmet që janë duke u bërë në të , mirëpo po që se nuk vazhdohet së ndërtuari kati i dytë dhe të përfundojë, vërtet dëmet do të jenë shumë të mëdha. Kjo është gjendja ashtu qysh është. Ne kemi kërkuar mjete edhe për vazhdimin e këtij objekti, por nuk kemi pasur mjete kështu që është mbetur që në të ardhmen brenda mundësive për ta ndërtuar”, shtoi drejtoi Lleshaj.

Haxhi Ibishi, tha se këtu kemi një plan vjetor të punës së KKSBB, që e tha edhe nënkryetari proceduralisht është dashur brenda janarit për të proceduar për miratim, por kanë qenë disa pengesa teknike jo të natyrës tjetër.

Kryesuesi vendosi planin për KKSBB për vitin 2016 për miratim, me plotësimin e kërkesës së këshilltares Zefaj, pa përjashtuar atë të Vlorës, mirëpo e Vlorës ishte i një natyre tjetër që nuk mund të inkorporohet në planin e punës, por u pajtua edhe Gjoka që gjendja nuk është e mirë, dhe se duhet për të intervenuar në një të ardhme në objektin, prandaj në miratojmë planin e punës së KKSBB.

Me 19 vota për, pa kundër, as abstenim u miratua plani i punës së KKSBB.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullore për masat disiplinore dhe kodin e mirësjelljes në të gjitha institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese në Komunën e Klinës (leximi i dyte, ref. Zyra ligjore).

Haxhi Ibishi, tha se kjo projekt-rregullore për herën e dytë që ka ardhur në Kuvend, është shterur me të gjitha rrugët ligjore, e kemi zgjeruar edhe atë komisionin, ato komisione kanë punuar të cilëve ju kemi ofruar edhe kushtet e punës prej meje dhe ekzekutivit dhe kemi ardhur në një stad ku rregullorja ka ardhur në formën përfundimtare.

Fadil Gashi, tha se e kemi kthyer një herë këtë rregullore dhe jemi dakorduar secili subjekt për t’i deleguar anëtarët e vet në përpunim të kësaj dhe unë kujtoj se kanë kryer punën e vet. “Nuk ma merr mendja që kemi nevojë më tutje”, shtoi anëtarja Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim Rregulloren.

Me vota uanime u miratua Rregullorja për masat disiplinore dhe kodin e mirësjelljes në të gjitha institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese në Komunën e Klinës.

Pika e shtatë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të Takimit me qytetarë i dt 21.12.2015.

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit në shqyrtim. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin.

Me vota unanime u miratua procesverbali i takimit me publikun të dt. 21.12.2015.

Pika e tetë: Shqyrtim i rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Haxhi Ibishi, sqaroi se këtë pikë të rendit të ditës në seancat e radhës pas debatit që do ta bëjmë në KPF na është rekomanduar që të mos jetë pikë e shqyrtimeve më në AK, të mos bëhet dyfishim të çështjeve, do t'u vije gjithmonë vetëm si material informues këshilltarëve dhe për qëndrimin e KPF-së karshi kërkesës që kanë bërë qytetarët e komunës sonë.

Hapi diskutimin. Nuk pati diskutime.

Kryesuesi vuri në miratim (në paketë) rekomandimet e KPF-së.

Me vota unanime u miratuan rekomandimet e KPF-së.

Pika e nëntë: Shqyrtimi i peticionit të banorëve të fshatit Poterq.

Kryesuesi foli rreth peticionit. Fjalën e barti te Vlora Tafili, në cilësinë e iniciueses së këtij peticioni.

Haxhi Ibishi, tha se edhe në seancën e kaluar edhe në këtë e kemi si pikë të veçantë me kërkesën e qytetarëve të fshatit Poterq atë problematikë prezantuar në Zyrën e kryesuesit dhe Shërbimin e Kuvendit këshilltarja nga radhët e AAK-së, Vlora Tafilaj. “Prandaj, me dakordimin e shefave të grupeve kuvendare dhe me anëtarët e KPF-së e kemi vendosur këtë pikë për shqyrtim këtë çështje”, shtoi Kryesuesi.

Vlora Tafili, në fillim i uroj mirëseardhje anëtarit Petrit Palushit bashkëngjitjes së tij në radhët e GP të AAK-së. Më pastaj anëtarja Tafili i kërkoj falje kryesuesit Dr. Haxhi Ibishit, sipas saj, për mënyrën e të drejtuarit në seancën e kaluar, thjesht, është shprehur lirshëm edhe në bazë të lidhjeve familjare. Anëtarja Tafili, pati edhe një kërkim falje tjetër për anëtarin Pjetër Coli, për rastin që, sipas saj, kam duartrokitur, thjesht ka qenë për iniciativën që ka marrë edhe që ka mbrojtur zërin e qytetarëve të tij. “Ndoshta jemi keqkuptuar pak, por kisha pasur dëshirë që publikisht dhe sinqerisht t’u kërkoj falje”, shtoi anëtarja Tafili, e cila në vazhdim foli rreth peticionit të banorëve të fshatit Poterq. “Çështja e fshatit Poterq është bërë e njohur, e kemi diskutuar edhe në debat me publikun, me “Jeta në Kosovës”, dhes se nuk kisha pasur dëshirë të hyj shumë në detaje për arsye se kemi arritur deri te një marrëveshje. Ka pasur shumë arsyeje se është dashur të përfundojë ky projekt, i cili është zvarritur prej vitit 2013, mirëpo më në fund Komuna ka ndërmarrë disa hapa, mirëpo janë edhe disa arsye pse ky projekt ka mbetur pa u përfunduar. Nuk kisha dëshiruar të ndalem shumë, duke ia nisur nga mospërfillja e kontratave, punës jo profesionale të kompanisë dhe deri te keqpërdorimi i mjeteve financiare. Mirëpo, sot para jush kam sjellë një peticion, sepse shumë herë faji u është hedhur banorëve të fshatit Poterq,

ky peticion është që ata për ta përfunduar ky projekt dhe për ta realizuar në mënyrën më të mirë. Edhe Drejtoria e Urbanizmit më në fund është vetëdijesuar, i kemi organet e drejtësisë, është marrë një vendim. Do të vazhdojë projekti i fshatit Poterq edhe banorët e fshatit Poterq kanë garantuar pronat e veta kah do të vazhdojnë këto punime hapësira. Ju kisha lutur Drejtorisë së Urbanizmit që sa më shpejt për t'i hapur procedurat deri në fund të marsit gjithqysh për t'i përfunduar, në fillim të muajit prill duam makinerinë në Poterq dhe për t'ia nisur punës”, shtoi theksoi anëtarja Tafili.

Fadil Gashi, tha se së pari kisha kërkuar konsideratë për peticionin, edhe nga kjo prezantuesja, edhe nga ekzekutivi, sepse unë kujtoj se peticioni na ka ardhur prej qytetarëve të Poterqit, edhe ata meritojnë ne për ta trajtuar shumë seriozisht “Edhe unë përshëndes nëse ka filluar iniciativa e ekzekutivit, është aq e mirë, po aq sa e presim të gjithë, pa përjashtim, po nëse ka ardhur një peticion ka ardhur prej qytetarëve dhe ata meritojnë për ta trajtuar në mënyrë të dinjitetshme. E them dinjitetshëm, e them me nderitetin dhe dinjitetin më të madh. Është një projekt që ne e kemi filluar kur ne kemi qenë në bashkëqeverisje me PDK-në, prandaj edhe ne e kemi trajtuar, si mungesë që bën Komuna e Klinës në shumë projekte të tilla, nuk është një, po që një ka ardhur me peticion dhe mu duk se disi është nisur, është filluar, më shumë mu duk si farë humori këtu, duke u bërë me një peticion, se sa diçka shumë serioze, për t'u marrë si dokument, krejt e ligjshme, krejt demokratike. Po kërkoj edhe një herë nga të dy palët, nëse doni për t'i ndarë tash në palë, dy palë janë, është pala që ka drejtuar peticionin tek ne dhe ne jemi palë, po përfshij edhe veten, si opozitë, edhe si pozitë që jeni ju, që duhet shqyrtuar atë peticion me seriozitet. Unë po kërkoj edhe prej drejtorit tash që po e shoh që po dëshiron ta marr fjalën, le të jetë serioz, kur ta pasqyron edhe aktivitetin e ekzekutivit që ka bërë për atë projekt”, vlerësoi anëtarja Gashi.

Haxhi Ibishi, theksoi se unë si Kryesues dhe kryetari Bashota, duke e parë natyrën serioze të këtij peticioni, e kemi sugjeruar që thjeshtë ekzekutivi të dal në terren dhe të sheh natyrën objektive të trajtimit të problemit të ngritur nga qytetarët. “Dhe kjo çështje që sot po debatohet është brenda afateve ligjore, flet për seriozitetin e kësaj asambleje, flet për seriozitetin e KPF-së, edhe të GP, se me koncensus e kanë vendosur për temë debati, dhe askush në KK e aq më pak PDK, si bartëse e pushtetit në Komunë nuk ka qëllim të zhvleftësimit të seriozitetit të kërkesës që bëjnë qytetarët në drejtim të Kuvendit Komunal. Prandaj, thjesht, ne jemi në nivel të përgjegjësisë edhe si të tillë kërkojmë të na pranohet edhe prej oponentëve politikë”, tha kryesuesi Ibishi.

Ndue Shabanaj, tha se çdo respekt për qytetarët e nënshkruar në këtë peticion. “Unë desha në një aspekt tjetër për ta thënë këtë çështje. Dihet rruga e aprovimit të projekteve me prioritet. Dihet mënyra e aprovimit të tyre dhe dihet se disa projekte që është investuar për realizimin e tyre nuk janë përfunduar. Angazhim parësor i pushtetit lokal, i drejtorisë përkatëse, edhe i gjithë neve duhet për të qenë projektet e filluara të përfundohen. Projektet për të cilat është investuar të hynë në funksion, të funksionalizohen. Dhe një çështje tjetër që desha ta them këtu, është duke u hapur një rrugë e cila nuk do të përfundon. Për këto projekte të tilla të ngjashme me lejuar formën e angazhimit të qytetarëve që përmes peticionit për t'u realizuar projektet. Do ta them mendimin tim pavarësisht a pajtohet apo nuk pajtohet dikush tjetër. Them se nuk duhet lejuar këtë pakënaqësi të shprehur, që kur shkruhet “peticion”, është shprehje e pakënaqësisë. Por obligimet që i ka pushteti lokal ndaj realizimit të projekteve të cilat janë miratuar si projekte me prioritet, kanë filluar të investohet, duhet për t'u realizuar pa ardhur në këto situata. Ky është

angazhimi që desha ta them si shqetësim dhe urrej të ndërpritet kjo formë e komunikimit për realizim të projekteve përmes peticionit”, konstatoi profesor Shabanaj.

Tunë Dedaj, tha se unë e shoh si të mirë dhe falënderoj edhe ekzekutivin, edhe Vlorën për arritjen e marrëveshjes që ata qytetarë më në fund ta kenë kanalizimin. “Do të thotë çdo marrëveshje e arritur me mirëkuptim që puna të kryhet unë e respektoj dhe e përshëndes, edhe në emër të GP të AAK-së”, tha anëtari Dedaj.

Ramush Agushi, tha se unë e përkrahi peticionin e fshatit Poterq, në një mënyrë edhe vetë qytetarët e fshatit Poterq e shohin tash se nuk ka qenë Komuna ajo që ka penguar këtë projekt, por dihen shkaqet kush e ka penguar. “Se Komuna ka qenë çdo herë e hapur për ta kryer këtë projekt, por pengesat ku kanë qenë, e kanë vërejtur edhe ata se aty nuk kanë pasur mundësi për ta kryer këtë projekt. Është arritur marrëveshja për t’u kryer ky kanalizim dhe jam sinjerisht shumë i gëzuar, për arsye se të gjithë e dimë se qysh dhe ku ka dalë ai problem. Unë veç e falënderoj edhe një herë më së pari fshatin Poterq që kanë gjetur mënyrën e realizimit të këtij projekti. E mbështes Komunën dhe besoj se Komuna ka për të shkuar prapa këtij projekti dhe do ta realizojë ashtu sipas marrëveshjes”, shtoi anëtari Agushi.

Baki Gashi, tha se desha një herë profesionit të nderuar t’i sqaroj se nuk është forma e zgjidhjes së problemit përmes peticioneve, mirëpo ky problem ka qenë i mëhershëm, dhe e dimë që mjetet që kanë qenë të dedikuara për finalizimin e këtij projekti, edhe i kemi ridestinuuar në rishikim të buxhetit të vitit të kaluar. “Unë personalisht kam pasur presion prej disa qytetarëve që nëse vazhdohet aty puna do të ndodh diçka që s’kemi dëshirë për të ndodhur. Dhe kjo ka qenë arsyeja që së paku 4-5 herë kam pasur në takim qytetarët e Poterqit dhe shlyqyr zotit që është mbërritur deri te një marrëveshje që nuk dëmtohet askush dhe ne, siç e tha edhe Ramushi, kemi qenë gjithëherë ta përfundojmë atë projekt dhe tash është arritur marrëveshja në mënyrën më të mirë që të kryhet ai projekt. Po flitet që ka shumë projekte të papërfunduara, unë nuk e di personalisht, projekte të papërfunduara është edhe një, në fshatin e Rasimit, edhe atje i njëjti problem, ka qenë edhe në Pogragjë, mirëpo e kemi kryer edhe atë muaj më herët, edhe aty ka qenë një presion i vazhdueshëm i një familje të cilët e kanë penguar kanalizimin që të kalojë nëpër pronat e tyre, mirëpo aty falë njerëzve është gjetur rruga dhe është kryer. I vetmi projekt me sa unë jam në dijeni është një projekt i kanalizimit në fshatin Ujëmir, edhe aty po them në prezencën e policisë qytetarët e asaj ane më kanë kërcënuar dhe askush nuk kemi dëshirë që vijmë deri te një e keqe, sepse këtu nuk jam që ta mbroj personalitetin, mirëpo e mbroj atë që jam i thirrur. Për projekte të tjera nëse dikush di që janë të papërfunduara dëshiroj t’i thoni, mirëpo unë nuk jam në dijeni. Thashë se nuk është forma e zgjidhjes së problemeve përmes peticioneve, mirëpo ky ka qenë një projekt i kahershëm, sepse po të shkohet në këtë formë, atëherë ishte dashur për ta pasur buxhetin 100 milion në vit”, theksoi drejtori Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se nuk e mendoj që aludimin e profesor Ndout, me sa unë e kuptova që të mos jetë mekanizëm, të mos jetë formë e presionit mbi institucionet. “Unë kështu e kuptova dhe mendoj që nuk ka asgjë të keqe”, tha Kryesuesi.

Ndue Shabanaj, theksoi se dëshirë të mirëkuptohem ne sepse edhe ashtu nuk ka kurrfarë arsye për të mos pasur mirëkuptim, se angazhimi im ishte ai që prezantova dhe se po të mos kem shënime unë nuk flas, një. “E dyta, kjo formë, sot u gjet zgjidhja, e dimë që është një projekt i filluar shumë më herët dhe nuk jemi ne jashtë rrjedhave normale të realizimit të këtyre projekteve, mirëpo jemi këtu. Dhe ka ardhur deri aty që është dashur deri me peticion. Tash u

gjend zgjidhja shumë shpejt! Aty ku erdhi zgjidhja pas këtij peticioni dhe ne realisht po njoftohemi sot se është gjetur zgjidhja për t'u realizuar ky projekt, që do të thotë ka pasur mundësi për t'u realizuar pa këtë peticion. Dhe ky është angazhimi im elementar, edhe themelor. Edhe ka projekte që është investuar dhe janë jashtë funksionit dhe ky është realitet dhe nuk dua të përmend këtu emra, mirëpo është kështu”, tha prof. Shabanaj.

Fadil Gashi, tha se bash prej vendit nga vjen drejtori ka projekte të papërfunduara. “Bash në fshatin e Kryetarit të Komunës kemi projekte të papërfunduara. Në fshatin tim kemi projekt që ke nisur dhe e keni lënë, në Resnik ke projekt të papërfunduar, edhe të mos i numëroj të gjitha. E the se “një e di që nuk është i përfunduar”, për atë edhe unë po kërkoj seriozitet. Ke projekte prej 2010 që kanë filluar dhe kurrë akoma funksionale nuk janë bërë!” – theksoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se ne jemi duke shqyrtuar peticionin e banorëve të Poterqit. “Nuk jemi duke u marrë me analizën e projekteve as me raportin e ekzekutivit i cili do të jetë dhe aty secili prej nesh e ka të drejtën e kontestimit të një pune, por jemi duke u marrë me çështjen konkrete të ngritur nga qytetarët e Poterqit. Më vjen mirë që ka ardhur kjo zgjidhje. Nuk e pëlqej formën e presionit mbi institucione për projekte nga qytetarët të cilat duhet të kryhen nga ekzekutivi të miratuara nga kjo asamble, për arsye se çelja e kësaj porte do të krijon presedan dhe do të krijon probleme të natyrave zinxhirore të cilat thjesht edhe vetë ekzekutivi nuk mund t'i kryejë për arsye se ka mungesa buxhetore, ka shkarje, ka shkarje nga punimet që mund të dalin shtesë, që mund të jenë pengesat në terren, janë forma të ndryshme të cilat pamundësojnë ndoshta në plotni për t'u realizuar një projekt. Ju kisha lutur që qytetarëve t'ju thuhet e vërteta që në vende ku ka probleme të natyrës konfliktuozë, sic ka qenë këtu në Poterq. Këtu nuk ka qenë çështje i investimit i cili nuk ka qenë i gatshëm për t'u realizuar prej Komune, por kanë qenë probleme pronëso- juridike, probleme të komunikimit në mes të fshatarëve edhe ndoshta ngritja e kësaj çështje që kanë bërë qytetarët, me insistimin e asamblistes Tafilaj, kanë ngritur ndërgjegjen e atyre që kanë qenë pengues që në bashkëpunim me ekzekutivin, në këtë rast me dy drejtori që kanë shkuar, kanë gjetur një marrëveshje. E përshëndes atë marrëveshje, edhe angazhohem, sigurisht që edhe ju, që ajo marrëveshje të realizohet. Por, sy nim të mos jetë presedan i cili nesër apo pasnesër hap portat edhe për projekte të cilat thjesht nuk mund të realizohen apo mbesin për faza të caktuara, ose njerëz të caktuar mund t'i manipulojnë qytetarët me kërkesa që në momente të caktuara nuk mund të realizohen”, theksoi kryesuesi Ibishi.

Enver Berisha, tha se ne në marrëveshje dhe në dakordim edhe me Kryetarin e Komunës dhe me Bordin e Drejtorëve bashkë jemi dakorduar, që ky projekt të zgjidhet sa më shpejt, mirëpo na është dashur paraprakisht një pëlqim më banorët e fshatit, këto dy gjera janë mbërritur dhe afati më i shkurtër ligjor që e lejon ai projekt do të realizohet. “Edhe për informatën të zv.ministrit, jemi në ngjarje që janë disa projekte ujësjellësve që janë jo funksional. Por falë një donacioni që kemi për këtë vit nga qeveria zvicerane, të gjitha projektet e ujët të pijshëm nëpër gjitha fshatrat ku janë në këtë vit do të funksionalizohen si rezultat i atij donacioni”, konstatoi nënkryetari Berisha.

Pjetër Coli, tha se të gjitha këto diskutime ishin rreth temës bosht. “Se po merren shembuj paralel që e kanë të njëjtin problem sikurse e ka edhe Poterqi. Sado që jo serioze duket ky vendim i sotëm, unë mendoj që ka qenë shumë i qëlluar që në atë fshat të përfundojë projekti i filluar para sa kohe. Apeloj te ekzekutivi që ky shembull i sotëm domethënë të shërbejë për punën e mëtutjeshme për të gjitha projektet e nisura dhe të papërfunduara sepse në këtë mënyrë e evitojmë atë që të mos bëhet dukuri peticioni nëse punët nuk kryhen. Ne kemi fshatin Budisalc, i

cili ka të njëjtin problem, që me vite ka filluar projekti dhe është i papërfunduar. Bile-bile edhe pjesa që është punuar ka filluar të rrënohet. Edhe apeloj që sa më shpejt edhe në Budislac, edhe në Jagodë të kryhet ose të përfundojë ky projekt”, theksoi anëtari Coli.

Pika e dhjetë: Pyetje dhe përgjigje nga këshilltarët.

Haxhi Ibishi, tha se ju kam mbetur borxh shefave të GP, në do ta bëjmë një takim ku do ta organizojmë këtë pikë të rendit të ditës për seancat e ardhme. Do ta vendosim brenda një kornize të një marrëveshjeje në mes të këshilltarëve të grupeve kuvendare. “Mund të jetë e hapur, po ashtu mund të jetë e pakufizuar për çështje të caktuara.

Kryesuesi hapi debatin.

Arben Limani, tha këtu po shihet se në këtë pikë të fundit drejtorët nuk po rrinë deri në fund edhe kjo tregon jo seriozitet nga ana e tyre. “Unë desha për ta pyetur drejtorin e Drejtorisë së Kulturës ose drejtorin e Urbanizmit, nuk di cili mund të na ofrojë atë mundësi, ose nënkryetari, për të na ofruar mundësinë e dokumentacionit të kryerjes së punimeve Shtëpisë së Kulturës. Aty dihet se është tenderuar, kanë përfutur disa punëkryerës në atë objekt, edhe pse është bërë vendosja e stafit të kulturës aty pa u bërë pranimi teknik”, tha anëtari Limani.

Vlora Tafili, tha se unë si asambliste kisha thënë kundër këtij vendimi që doni për të marrë që këtë pikë për të na hequr neve si asamblistë këtë hapësirë, pyetje dhe përgjigje.

Haxhi Ibishi, tha se ndoshta jam keqkuptuar prej jush, unë e thashë do të konsultohem me shefat e grupeve dhe do ta fusim në një kornizë që edhe në kohë për të qenë e kapshme jo të mbetet në këtë mënyrë që është për momentin, e jo që ka për qëllim të heq ndokush.

Ndue Shabanaj, tha se kërkesa ime është të informohemi dhe unë kërkoj edhe angazhim konkret, që sipas njohurive që kam KEDS-i ka një program të ndërrimit të shtyllave elektrike nëpër fshatra dhe zëvendësimit të shtyllave që janë të vjetra dhe nga druri të zëvendësohen me ato të betonit, dhe ka program gjithashtu edhe për riparimin e rrjetit elektrik. “Unë sipas informatave që kam nganjëherë po hoqi dorë për të shkuar me emër fshat për fshat dhe kjo në një formë po më hakmerret se unë po flas në përgjithësi dhe po krijohet një përshtypje se nuk po angazhohem në veçanti. Dua të them se disa fshatra janë të rrezikuar banorët për shkak të rrjetit elektrik shumë të vjetruar dhe për shkak të shtyllave elektrike të cilat janë shumë të vjetra dhe janë vend e pavend dhe nuk janë në hapësira ku duhet për të qenë dhe janë të rrezikuar qytetarët. Unë kërkoj nga pushteti lokal në Klinë në bashkëpunim me KEDS-in të angazhohet në këtë drejtim në ndërrimin e shtyllave dhe riparimin e rrjetit elektrik sipas mundësive që ka KEDS-i, por edhe Komuna. Është e papranueshme ku regjione të tëra për një frymë krejt fare të lehtë mbesin me orë dhe ditë të tëra pa rrymë. Dhe një praktikë e tillë ishte dashur të mos i lejohet as KEDS-it, është dashur që ta bëjmë si presion edhe si pushtet lokal në këtë drejtim”, theksoi prof. Shabanaj.

Tunë Dedaj, tha se nuk di pse po zvarritet ndarja e atyre dy trojeve që janë për xhami dhe kishë në Këpuz dhe Deiq. “Edhe qytetarët ma thonë dhe shprehin interesimin e tyre, prandaj është mirë të përfundojë kjo çështje pasi që edhe ne ia kemi dhënë bekimin si assemble, le të kryhet, se di asnjë arsye, pse po zvarritet”, shtoi anëtari Dedaj.

Baki Gashi, tha se sa i përket rrjetit elektrik në tërë rajonin e Klinës është bukur shumë i dëmtuar. “KEDS-i na i ka kërkuar hartat dhe ne ju kemi ofruar ato edhe me sa jemi në dijeni ata janë duke e bërë riparimin në dy fshatra, në Këpuz dhe Përqevë, dhe e kanë një plan të veprimit, se ata punojnë sipas planit të veprimit të tyre. Besoj se në vazhdimësi janë të angazhuar të përfundojnë nëpër gjithë territorin jo vetëm të Komunës së Klinës, por edhe gjithë Kosovën”, sqaroi drejtori Gashi.

Ndue Shabanaj, tha se unë kërkoja për të mos lejuar krejt ky proces të shkojë në mënyrë selektive dhe atë seleksiono për ta bërë KEDS-i. “Unë thashë që ta kemi edhe ne ndikimin tonë si pushtet lokal dhe për ta marrë për bazë gjendjen reale, faktike, të fshatrave, edhe orientimin aty ku ka nevojë më shumë. E jo sipas preferencave të grupeve dhe të individëve të caktuar”, theksoi prof. Shabanaj.

Enver Berisha, foli rreth çështjes tematike. Nënkryetari theksoi për shkak të korrektësisë po ju sigurojë që shumë shpejt unë kam insistuar për ta pasur një takim edhe për të shikuar realisht sa janë ato mundësi të investimeve të tyre në këtë periudhë dhe për ta dhënë kontributin dhe angazhimin tonë që realisht të jetë një projekt i balancuar në terren.


Haxhi Ibishi, tha se kam një obligim moral, Vlorës dhe OJQ “Koha” t’u sqaroj se a kam dashur apo nuk kam dashur për ta lejuar një qytetar për të qenë pjesë e seancës së sotme. “Është një rregull i përcaktuar, së pari janë publike të gjitha seancat, por është një rregull që qytetarët të caktuar që duan të marrin pjesë në seanca duhet paraprakisht 24 orë përpara për t’iu drejtuar Shërbimit të Kuvendit, konkretisht Kryesuesit, edhe duhet në kërkesë me tekst për çështjen që i intereson për të marrë pjesë në seancë e cila debatohet. Është një procedurë që askujt nuk ia mohojmë. Uroj që sot të përfundojë çështja mirë në Kosovë dhe shqiptarët le ta dinë se janë vëllezër ndër vete”, shtoi kryesuesi, dr. Ibishi.

Kryesuesi Ibishi, falënderoi anëtarët për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI



Kryesuesi i Kuvendit,
Dr. Haxhi IBISHI